




# Labirint



Sumeja dëshiron të mësojë Kur'an.  
Ndhimoi asaj që të arrijë deri tek klasa!



Klasa e Kur'anit

Muhamedi, - Pejgamberi i Allahut (paqja qoftë mbi të) ka thënë, : "Më i miri prej jush është ai që e mëson Kur'anin, dhe ua mëson atë të tjerëve."

**A di të lexosh Kur'an?**

Nëse jo, lute dikë të të mësojë të lexosh dhe të kuptosh Kur'anin, që të mund të përfitosh nga mësimet e tij të shumta!



Kur'an

# Bashko fjalët

Varësisht prej momenteve në jetë, ka fjalë të caktuara të cilat duhet t'i themi që ta përkujtojmë Allahun. Lidh fjalët në të majtë me ato në të djathtë.



Selam alejkum  
(paqja qoftë mbi ty)

Kur gabojmë diçka



Allahu Ekber  
(Allahu është më i madhi)

Para se të bëjmë diçka



InshaAllah  
(Në dashtë Allahu)

Për ta falënduar Allahun ose kur teshtijmë



Bismilah  
(Në emër të Allahut)

Kur takon një musliman



Allahu të shpërbleftë

Kur fillojmë namazin



Elhamdulillah  
(Falënderimi i takon Allahut)

Kur falënderojmë dikë



Estagfirullah  
(Kërkoj falje nga Allahu)

Kur dëshirojmë të bëjmë diçka në të ardhmen

Të lumtë për kryerjen e të gjitha aktiviteteve (lojrave)! Tani kërko nga prindërit që të kontrollojnë përgjigjet e tua dhe të të ndihmojnë me ato që nuk i ke kuptuar. Mos harro që t'i bindesh Allahut dhe të jesh i mirë me prindërit e tu. Fale namazin me kohë dhe bëhu një musliman i mirë, ashtu që Allahu të jetë i kënaqur me ty, dhe të të fusë në xhenet, inshaAllah.



# Islami per fëmijë

Mëso Islamin përmes lojrave zbatimëse!



# kuptimet themelore

islamifejavertete.com

## Informacion

t 045-633-370 w islamifejavertete.com e broshurat@gmail.com



# Tregim Islam + Kuiz



# Fjalëkryq

## këndi i fëmijëve

Xhaxhi Hasan kishte tre djem: Aliun, Enesin dhe Afanin. Ata i donte shumë dhe dëshironte që të rriten dhe të bëhen muslimanë të mirë.

Xhaxhi Hasan vetë ishte një musliman i mirë dhe përpiquej që t'i bindej Allahut . Një ditë, deshi që t'i testonte bijtë e tij. I dha secilit prej tyre disa bonbone dhe tha: "Hani ato në një vend, ku askush nuk mund t'iu shohë, e pastaj kthehuni tek unë."

Aliu mori bonbonet dhe shkoi në dhomën e tij. Mbylli derën nga brenda, tha: "Bismillah" dhe pastaj i hëngri duke menduar se askush nuk mund ta shohë atë.

Enesi shkoi në bodrumin e shtëpisë duke qenë i sigurtë se askush nuk ishte aty. Tha: "Bismillah" dhe hëngri ëmbëlsirat në dhomën e errët të bodrumit.

Afani u mendua gjatë për një vend ku ai mund të hante bonbonet pa e parë askush. Nuk i binte ndër mend për një vend të tillë. Sa herë që mendohej për një vend të tillë, i kujtohej se Allahu mund ta shohë atje dhe kështu mbeti pa i ngrënë bonbonet.

Aliu dhe Enesi u kthyen dhe i treguan babait të tyre se çfarë bënë ata. Afani erdhi dhe ia ktheu ëmbëlsirat babait të tij duke i thënë: "Nuk ekziston ndonjë vend në të cilin Allahu nuk të sheh, prandaj unë nuk i kam ngrënë bonbonet."

Xhaxhi Hasan ishte shumë i kënaqur me Afanin dhe i tha Aliut dhe Enesit që të mësojnë nga veprimi i vëllait të tyre.

Ai u tha djemve të tij: "O bijtë e mi të dashur, gjithmonë mbani në mend se Allahu di gjithçka dhe Ai sheh gjithçka. Ai mund të na shohë kudo që jemi. Pra, nuk duhet të bëjmë vepra të këqija edhe nëse jemi në vetmi - sepse Allahu di dhe sheh gjithçka."

### Pyetjet (rretho përgjigjen e saktë)

- Xhaxhi Hasan dëshironte që fëmijët e tij të:
  - dinë të fshihen
  - bëhen muslimanë të mirë
  - hanë shumë
- Xhaxhi Hasan përpiquej që:
  - të blejë bonbone
  - t'i mësojë të fshihen
  - t'i bindej Allahut
- Çfarë duhet të themi para se të hamë diçka?
  - Mmmm!
  - Vjen aromë e mirë!
  - Bismillah
- Në cilin vend nuk na sheh Allahu?
  - në një dhomë të mbyllur
  - në bodrum
  - Allahu na sheh çdokund

A	M	S	D	N	U	H	F	A	U	T
S	I	M	K	R	O	X	Z	K	R	I
R	R	A	T	F	B	U	T	Ë	SH	Y
K	Ë	Y	P	I	S	A	Z	T	V	Q
DH	T	G	S	P	U	A	S	DH	F	R
F	D	Ë	GJ	U	E	SH	Ë	M	A	S
G	I	B	R	A	H	I	M	P	C	D
A	S	Ë	T	I	V	M	R	N	Q	U
F	V	G	S	DH	T	E	K	I	M	S
Q	F	J	K	F	A	X	U	T	U	LL
T	A	M	N	A	S	V	J	R	H	C
P	N	H	U	L	R	T	D	T	A	Z
S	G	DH	P	E	Y	M	E	S	M	O
F	M	G	H	N	B	U	S	SH	E	H
H	D	V	T	D	A	S	SH	Y	D	M
N	C	D	A	E	S	A	Ë	M	D	T
R	T	A	I	R	D	G	M	Ë	B	S
V	D	SH	O	U	S	R	T	SH	F	D
E	Ë	U	S	E	P	R	U	I	U	F
O	T	R	V	S	B	X	M	R	Q	DH
I	J	H	F	E	A	D	S	SH	I	J
S	R	T	D	Ë	GJ	O	N	Ë	SH	I
A	U	R	T	Ë	T	Z	G	M	Ë	U
Y	U	Q	E	U	S	A	D	E	M	D
R	G	J	T	K	I	H	N	D	X	T
N	T	Y	D	I	J	SH	Ë	M	J	G

Allahu është...		Ndaj prindërve, muslimani duhet të jetë..	Emrat e disa prej pejgamberëve (paqja qoftë mbi ta)
I Gjithë	fuqishëm	i mirë	Adem
I Gjithë	dijshëm	i butë	Nuh
I Gjithë	mëshirshëm	i dashur	Ibrahim
I	Urtë	i kujdesshëm	Musa
Ai që gjithçka	dëgjon	i dëgjueshëm	Isa
Ai që gjithçka	sheh	falenderues	Muhamed

Për të gjetur mesazhin e fshehur në fjalëkryq, shkruaj çdo të pestën shkronjë në hapësirat e mëposhtme.

Mesazhi i fshehur: NUK \_\_\_\_\_

# O Allah, Ty të falënderoj

Të falënderoj o Allah për çdo gjë që më ke dhuruar,  
 E di, jam mëkatar, faljen Tënde gjithnjë kam dëshiruar.  
 Të lutem, më bëj çdo ditë e më të përmirësuar,  
 Ma hap zemrën time e forcoma vullnetin gjithnjë për të të adhuruar.  
 Për të Dërguarin Muhamed, të cilin e dua, të falënderoj o Allah që e ke dërguar,  
 Të lutem o Allah, jepi atij Xhenetet më të larta duke e lartësuar.

## Përse e adhurojmë Allahun?

### Plotëso Zbrazëtitrat!

Përzgjidh fjalët e duhura për hapësirat e mëposhtme. A mund t'i vendosësh në vendet e tyre? (Shënim: 4 fjalë teprojnë)

Namazit    Xhibril    hamë    Allah    Haxhin    pëlqej  
 Kur'an    Muhamed    Sheval    drekë    lejuar    Xhenet  
 pimë    Ramazanit    lëmoshë    adhurojmë    Ibrahim    iftar

Muslimanët adhurojnë Zotin e vetëm dhe emri i Tij është \_\_\_\_\_.  
 Allahu na ka krijuar neve dhe Ai do që ne ta \_\_\_\_\_. Atë, që kur ne të vdesim të shkojmë në \_\_\_\_\_. Që të dimë se si ta adhurojmë Allahun, Ai na dërgoi një pejgamber të madh me emrin \_\_\_\_\_.  
 Meleku \_\_\_\_\_ u dërgua nga Allahu për t'ia shpallur pejgamberit një libër madhështor me emrin \_\_\_\_\_. Duke ndjekur mësimet e Kur'anit ne mësojmë se çfarë është e \_\_\_\_\_ dhe çfarë e ndaluar. Ne duhet ta mësojmë Kur'anin dhe t'ua mësojmë të tjerëve.

Një ndër mënyrat më të mira për të adhuruar Allahun dhe për t'u shpërblyer shumë është agjërimi i muajit të \_\_\_\_\_. Në këtë muaj të madhërishtëm nuk lejohet të \_\_\_\_\_ dhe të \_\_\_\_\_ prej syfyrit deri në \_\_\_\_\_. Mënyra të tjera për të arritur shpërblym të madh janë falja e \_\_\_\_\_ 5 herë në ditë ose t'u japim \_\_\_\_\_ atyre që kanë nevojë. Muslimanët poashtu duhet ta kryejnë \_\_\_\_\_ një here në jetën e tyre. Nëse ne i kryejmë këto obligime ashtu si kërkohet, shpresojmë se Allahu do të na i falë të gjitha mëkatet!

